

eppc kërkon një *Menaxher Dyqani* për klientin e saj, i cili operon në fushën e shitjeve të produkteve elektronike dhe elektroshtëpiake në vend.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhimi dhe motivimi i stafit të dyqanit për të maksimizuar efikasitetin në punë me qëllim rritjen e shitjeve ditore;
- Supervizimi i stafit, ndjekja me rigorozitet e disiplinës në punë, organizimi dhe zbatimi i turneve dhe orareve të punës për personelin e dyqanit;
- Menaxhimi i niveleve të stokut dhe kontrollit të tij;
- Organizimi i promociioneve në nivel dyqani;
- Përpilimi i raporteve statistikore periodike me qëllim analizimin e shitjeve dhe parashikimin për rritjen e tyre në të ardhmen me qëllim maksimizimin e përfitimeve nga dyqani;
- Përfshirja në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të kënaqshëm klientëve, si dhe ndjekja e procesit të porosive;
- Sigurimi i standarteve të cilësisë, paraqitjes dhe vendosjes së mallit në dyqan;
- Bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha departamentet e tjera me qëllim ndjekjen e të gjitha çështjeve të dyqanit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë e mëparshme në sektorin e shitjeve (*Eksperienca në Retail është avantazh*);
- Të zotëroj shumë mirë gjuhën Angleze;
- Të zotëroj shumë mirë paketën MS Office (*Word-Excel*);
- Të jetë fleksibël, i adaptueshëm energjik dhe i besueshëm;
- Të shfaq aftësi të mira problem-zgjidhëse dhe të menaxhimit të stresit.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher Dyqani;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	45 orë në javë;
Pagesa:	Shumë e mirë;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	5.12.2014.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.